

Tabela D2 është pjesë e tabelave të FPT

4.2 Burimi i të ardhurave- referuar tabelës F1 të FPT

Arsyet/Faktoret në planifikimin e të ardhurave ndër vite

Te ardhurat nga taksat vendore

Të ardhura nga Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël

Planifikimi bëhet nga agjenti tatimor si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara rereferuar numrit të procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga vetë ato. Të ardhurat ngakjo taksë parashikohen me një rritje prej 1% në vit.

Të ardhura nga Taksa mbi pasurinë e paluajtshme

a) Të ardhura nga taksa mbi ndërtesat

Parashikimi me rritje 1% për vitet 2019-2021 bazohet te kapaciteti si dhe zgjerimi i bazës së taksapaguesve nëpërmjet:

saktësisimit dhe vlerësisimit të drejtë të sipërfaqeve nëpërmjet grupeve të punës të ngritura për këtë qëllim,

Mbështetja nga agjentë tatimorë,

Ndarjes në këste të pagesave,

shtimit të arkave funksionale më pranë zonave të banuara në njësitë administrative.

shtrirje e mëtejshme e bazës taksapaguese, falë politikave fiskale lehtësuese dhe incentivave të ndërmarra, rivlerësisimit të gjendjes faktike, përmirësisimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, si dhe bashkëpunimit të prishëm me institucione si ZRRPP, ALUIZNI etj

b) Të ardhura nga Taksa mbi tokën bujqësore

Planifikimi i të ardhurave bazohet mbi kapacitetin aktual fiskal të njërive administrative, mbi parashikimin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve nga grupet e punës nëpërmjet saktësisimit të sipërfaqeve reale dhe kategorizimit të saktë dhe aktual të tokës bujqësore, si dhe duke iu referuar tendencës në rritje të kapacitetit të realizimit të të ardhurave ndër vite. Të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore parashikohen me një rritje prej 1% në vit.

c) Të ardhura nga Taksa mbi truallin

Planifikimi i të ardhurave është bërë duke u bazuar në sipërfaqet aktuale, dhe mbi parashikimin për zgjerimin e bazës së taksapaguesve nga grupet e punës nëpërmjet saktësisimit të sipërfaqeve. Të ardhurat nga taksa e truallit parashikohen me një rritje prej 1% në vit.

Të ardhura nga Taksa e fjetjes në hotel

Planifikimi i të ardhurave me një rritje prej 1% në vit është bërë ju referuar kapacitetit aktual dhe parashikimit të zgjerimit të tij, rritjes së numrit të njërive, si dhe shtrirjen periudhave të sezoneve turistike për ushtrimin e aktivitetit,.

Të ardhura nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë

Plani i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë me rritje prej 1% bazohet mbi parashikimin e lejeve për ndërtime të reja dhe shlyerjen e detyrimeve për objektet në proces legalizimi .

Të ardhura nga Taksa e Tabelës

Parashikimi në rritje prej 1% i të ardhurave bazohet në rritjen e njësive takapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese.

Të ardhurat nga Taksat e Ndara

Të ardhura nga Taksa e regjistrimit të mjeteve të përdorura

Planifikimi i të ardhurave që vilen nga agjenti tatimore rritje 1% bëhet duke ju referuar numrit të automjeteve si dhe bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara rereferuar të dhënave për nivelet e arkëtimeve.

Të ardhura nga taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme

Planifikimi i të ardhurave që vilen nga agjenti tatimor me rritje 2% bëhet duke u bazuar në eksperiencën e viteve të kaluara rereferuar numrit të procedurave të tjetërsimit të pronës të kryera nga vetë ato.

Të ardhura nga Taksa e Rentës minerare

Planifikimi i të ardhurave i referohet realizimit të të ardhurave ndër vite, dhe nuk parashikohet ndryshime.

Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale

Planifikimi i të ardhurave i referohet realizimit të të ardhurave ndër vite nga agjenti tatimor. Të ardhurat për parashikohen me një rritje prej 1% në vit.

Te ardhurat nga Tarifate Vendore

Parashikimi në rritje afërsisht 1% i të ardhurave për pastrimin, ndriçimin dhe gjelbërimin bazohet tek kapaciteti aktual dhe në rritjen e njësive takapaguese e në evidentimin e kapaciteteve të reja, si dhe në shtrirjen e mëtejshme të bazës taksapaguese falë politikave fiskale lehtësuese, përmirësimit të shërbimit dhe marrëdhënies me taksapaguesin, fokusimit në zona me kapacitete të pashfrytëzuara, si dhe sensibilizimin dhe trajtimin e biznesit si partner në dhënien e shërbimeve për komunitetin.

Të ardhura nga tarifa për shërbimet administrative

Nga tarifa për shërbimet administrative që bashkia ofron si ato të drejtorisë të zhvillimit të territorit për aplikimet për leje, kontrolle dhe verifikime, për aplikimet për AMTP-të etj si efekt i implementimit të disa tarifave të reja në paketën fiskale, planfikohet rritje prej 5% të ardhura në vit, si rezultat i trendit të rritur të kërkesave.

Të ardhura nga Tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura

Zëri tarifa për vulosje veterinare të bagëtive të therura pas verifikimit të mishit të bagëtive të therura ne vende të aprovuara parashikon të ardhura me rritje 4% në vit nga tarifimi për vendosje vule nga veterineri i autorizuar, si rezultat i rrijës së kërkesës dhe kontrolleve.

Të ardhura nga Tarifate e liçensimit te veprimtarive te transportit

Plani i të ardhurave të parashikuara me rritje 1% në vit bazohet tek trendi i aplikimeve të tarifate e miratuara nga Ministria e Financave për subjektet që pajisen me liçensën dhe çertifikatën përkatëse për transport udhëtarësh ose mallrash, për vete ose për të tretë.

Të ardhura nga Tarifa e parkimit për mjetet e licencuara dhe për vendparkime publike

Të ardhurat e planifikuara nga tarifa e parkingut për mjetet që janë pajisur me një licensë transporti, dhe një pjesë e tyre kanë vende të caktuara me sinjalistikë të veçante rrugore si taksi, mikrobusë, autobusë etj., ku parashikohet një rritje prej 1% e kërkesave.

Te ardhura nga Tarifa për dhënie licensë për tregtimin të naftës bruto e n/produkteve

Bazuar në VKM Nr. 970, dt 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, ky zë parashikon rritje prej 1% të ardhura viti nga subjekte me aktivitet tregtim karburanti, që pajisen me licensën përkatëse.

Të ardhura nga Tarifat e sektorit të pyjeve dhe kullotave

Të ardhurat e parashikuara me rritje 1% në vitin bazohen në trendin e aplikimeve të tarifave të shërbimeve administrative që kryen sektori i pyjeve dhe kullotave.

Të ardhura nga Tarifat e shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri

Të ardhurat e parashikuara me rritje 1% bazohen në nivelin e tarifave të shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit ndaj shtetasve dhe personave, juridik e fizik, vendas e të huaj, si dhe në realizimin e të ardhurave vitet e kaluara nga kjo strukturë.

Të ardhura nga Tarifa për zënie e hapësirave publike

Parashikimi i të ardhurave me rritje 1% është bërë duke ju referuar kërkesës në vite dhe trendit në rritje për shfrytëzimin e hapësirave publike brenda juridiksionit të Bashkisë.

Të ardhura nga Tarifat për linjat ajrore dhe nëntokësore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet)

Parashikimi i të ardhurave me rritje 1% është bërë duke ju referuar kapaciteteve të hapësirave brenda juridiksionit të Bashkisë.

Të ardhura nga tarifat për veprimtaritë në institucione të arsimit, kulturës, sportit, shërbimit social etj.

Parashikimi i të ardhurave me një rritje prej 0,5 % është bërë duke ju referuar kapaciteteve të këtyre institucioneve, si dhe realizimit ndër vite.

Te ardhura të tjera

Të ardhura nga dhënia me qira e aseteve në pronësi të Bashkisë

Parashikimi i të ardhurave me 1% në vit është bërë duke ju referuar kontratave vijuese dhe kapaciteteve brenda juridiksionit të Bashkisë.

Te ardhurat nga kundravajtje administrative/gjobat, si dhe zhdëmtime

Parashikimi i të ardhurave me rritje 1% në vit është bërë duke ju referuar trendit të të ardhurave ndër vite kryesisht nga kamatvonesat për shlyerje pas afatit të detyrimit tatimor të bizneseve, nga gjobat e Policisë Bashkiake dhe nga gjobat e vendosura nga Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve

Për zërin të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve, referuar realizimit të viteve të kaluara, rritja është parashikuar 1%.

Të ardhura nga Donacionet

Të ardhura nga donacionet

Meqënëse planifikimi i të ardhurave bazohet mbi marreveshjet për sponsorizime dhe donacione, nuk parashikohen ndër vite të ardhura nga ky zë.

4.3 Shpenzimet

Shpenzimet ne vitet 2016-2021 ne pjesen me te madhe mbulohen nga transferta te kushtezuar , transferte specifike dhe tarifa me destinacion mesatarisht 65.2% ndersa me transferte te pakushtezuar dhe te ardhura te tjera mbulohen vetem 34.8%. Konkretisht ne vitin 2019 mbulohen me transferte te pakushtezuar dhe te ardhurat e veta 34.5% dhe 65.5% me transferta te kushtezuar , transferte specifike dhe tarifa me destinacion , ne vitin 2020 mbulohen me transferte te pakushtezuar dhe te ardhurat e veta ne masen 35.3% dhe dhe 64.7% me transferta te kushtezuar , transferte specifike dhe tarifa me destinacion ,ne vitin 2021 mbulohen me transferte te pakushtezuar dhe te ardhurat e veta ne masen 35% dhe 65% me transferta te kushtezuar , transferte specifike dhe tarifa me destinacion.

Ne vitin 2020 shpenzimet e pergjitheshme jane rritur me 0.8% ne raport me vitin 2019 , ne vitin 2021 jane rritur 8.1% ne raport me vitin 2021 .

Shpenzimet per paga ne vitin 2020 jane rritur me 1.6% ne raport me 2019 ndersa ne vitin 2021 jane rritur 2% ne raport me 2020 .

Shpenzimet korente ne vitin 2020 jane rritur me 1.3% ne raport me 2019 ndersa ne vitin 2021 jane rritur 9% ne raport me 2020.

Shpenzimet kapitale ne vitin 2020 nuk kane rritje ne raport me 2019 ndersa ne vitin 2021 jane rritur 16.9% ne raport me 2020.

Ne **vitin 2019** jane planifikuar shpenzime bruto ne shumen 2 994 147 mije leke ku peshen me te madhe specifike sipas programeve e ze Nenfunksioni 104Familja dhe femijet me 35.6% , Nenfunksioni 011 Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme me 9.1 % ,Nenfunksioni 091 me Arsimi baze dhe parashkollor me 10.9% .

Paga dhe sigurime shoqerore zene 23 % ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike 33.3 % e ze Nenfunksioni 011 Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme , 29.2% e ze Nenfunksioni 091 me Arsimi baze dhe parashkollor, dhe 7.7% e ze Nenfunksioni 092 Arsimi i mesem .

Shpenzimet korente zene 58 % ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike e ze Nenfunksioni 104Familja dhe femijet me 58.6%, Nenfunksioni Menaxhimi i mbetjeve me 11.3% dhe Nenfunksioni 081 Sherbimet clodhese dhe sportive me 4.8%.

Shpenzimet kapitale zene 19% ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike me 45.5 % e ze Nenfunksioni 045 Transporti, 16.2% e ze Nenfunksioni 063 Furnizimi me uje dhe 6.4% e ze Nenfunksioni 081 Sherbimet clodhese dhe sportive.

Ne **vitin 2020** jane planifikuar shpenzime bruto ne shumen 2 770 477 mije leke ku peshen me te madhe specifike sipas programeve e ze Nenfunksioni 104 Familja dhe femijet me 39% , Nenfunksioni 011 Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme me 10.4 % dhe Nenfunksioni 045 Transporti me 9.8%.

Paga dhe sigurime shoqerore zene 25% ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike 33.4 % e ze Nenfunkcioni 011 Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme, 29.1% e ze Nenfunkcioni 091 me Arsimi baze dhe parashkollor, dhe 7.7% e ze Nenfunkcioni 092 Arsimi i mesem .

Shpenzimet korente zene 63.8 % ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike e ze Nenfunkcioni 104 Familja dhe femijet me 59%, Nenfunkcioni Menaxhimi i mbetjeve me 11% dhe Nenfunkcioni 081 Sherbimet clodhese dhe sportive me 4.7%.

Shpenzimet kapitale zene 11.2% ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike me 75.6 % e ze Nenfunkcioni 045 Transporti, 6.1% e ze Nenfunkcioni 064 Ndricimi rrugor dhe 5.3% e ze Nenfunkcioni 092 Arsimi i mesem.

Ne **vitin 2021** jane planifikuar shpenzime bruto ne shumen 2 995748 mije leke ku peshen me te madhe specifike sipas programeve e ze Nenfunkcioni 104 Familja dhe femijet me 41.2% , Nenfunkcioni 011 Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme me 10.2 % dhe Nenfunkcioni 045 Transporti me 9.6%.

Paga dhe sigurime shoqerore zene 23.6% ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike 34.1 % e ze Nenfunkcioni 011 Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare, fiskale, dhe çështjet e brendshme , 29% e ze Nenfunkcioni 091 me Arsimi baze dhe parashkollor, dhe 7.6% e ze Nenfunkcioni 092 Arsimi i mesem .

Shpenzimet korente zene 64.4 % ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike e ze Nenfunkcioni 104 Familja dhe femijet me 62.1%, Nenfunkcioni Menaxhimi i mbetjeve me 10.2% dhe Nenfunkcioni 081 Sherbimet clodhese dhe sportive me 4.4%.

Shpenzimet kapitale zene 12% ndaj totalit dhe peshen me te madhe specifike me 69.1 % e ze Nenfunkcioni 045 Transporti, 5.5% e ze Nenfunkcioni 041 Çështje të përgjithshme ekonomike, tregtare dhe të punës dhe 5.3% e ze Nenfunkcioni 064 Ndricimi rrugor.

Ne shpenzimet totale nuk eshte perfshire fondi rezerve i planifikuar per 2019-2021 (kjo referuar FPT). Ne vitin 2019 eshte planifikuar shuma 4 949 mije leke , ne vitin 2020 eshte planifikuar shuma 2 484 mije leke dhe ne vitin 2021 eshte planifikuar shuma 3 023 mije leke.

Komente referuar tabelës F6 dhe F7 te FPT.

4.4 Rezultati total i buxhetit

Balancen e te ardhurave dhe shpenzimeve per vitet 2016-2021 e gjeni te FPT ne sheet F(13) Permbledhja ne tabelen –Statistika Financiare te pergjithshme. Ne kete tabele jepet balanca per vitet 2019-2021 qe eshte zero pra te ardhurat e planifikuar dhe shpenzimet e planifikuara jane te barabarta. Ndersa ne vitin 2017 verehet diferenca pozitive (Perfitime) prej 658558 mije leke , keto jane fonde qe kane mbetur gjendje si rrjedhoje e bllokimit te thesarit ne muajin tetor-dhjetor 2017. Ndersa ne vitin 2016 kemi diference pozitive (Perfitime) ne shumen 445284 mje leke edhe kjo si rrjedhoje e shpenzimeve te palikuiduar ne fund te vitit 2016 dhe kalimin e tyre per likuidim ne vitin 2017. Ndersa ne vitin 2018 kemi balance pozitive 10 682 mije leke ku perfshihet 10 675 mije leke fond rezerve gjendje e paperdorur dhe 7 mije leke takse minerare e akorduar nga qeveria. Bashkia nuk ka borxhe te mbartura sepse ne asnje vit nuk ka qene me balance negative por ka procedura te prapambetura te viteve te kaluara (fatura apo kontrata) te cilat nuk jane likuiduar per mangesi ne dokumentacion edhe pse fondet per likuidimin e tyre jane te disponueshme dhe konkretisht te gjendet qe reflektohen ne vitin 2016 dhe 2017 dhe 2018 . Per kete arsye eshte ngritur dhe nje grup pune per vlersimin e procedurave meqenese disa prej tyre kane periudhe mbi 5 vjet .

Referuar Tabeles –Statistika Financiare te pergjithshme (F13)

4.5 Informacion financiar suplementar

4.5.1 Huamarrje 6

Bashkia Shkoder nuk ka huamarrje

Tabela F1, seksioni C për huatë e reja, financimin me kredi është zero.

4.5.2 Detyrime të prapambetura

Bashkia Shkoder ka detyrime të prapambetura në shumën 63 211 mijë leke që janë procedura të prapambetura të viteve të kaluara (fatura apo kontrata) të cilat nuk janë likuiduar për mangësi në dokumentacion edhe pse fondet për likuidimin e tyre janë të disponueshme dhe konkretisht të gjendjet që reflektohen në vitin 2016 dhe 2017 dhe 2018. Për këtë arsye është ndritur dhe një grup pune për vlerimin e procedurave meqenëse disa prej tyre kanë periudhë mbi 5 vjet .

Tabela C3 dhe F12 Detyrime të prapambeturat është zero

4.5.3 Treguesit financiarë

Referuar tabelës F14 të FPT sqarojmë se norma totale e shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave për vitet 2016 është 83.1% ndërsa për vitin 2017 është 78.5% si rrjedhojë e gjendjes së trashëguar në fund të viti 2016 dhe 2017. Në vitin 2018 është 99.7% sepse kemi planin e pritshëm të 2018 dhe deri në këtë moment planifikojmë që do realizohen të ardhurat e planifikuara dhe ndërsa është gjendje 10 682 mijë leke fond rezerve dhe taksa minerare . Ndërsa për vitet 2019-2021 është 100%.

Raporti i të ardhurave nga burimet e veta në raport me të ardhurat e përgjithshme varion nga 19.2 % në vitin 2016 në 25.4 në vitin 2019.

Kemi rritje të shpenzimeve kapitale ndaj totalit të shpenzimeve nga viti 2019 në 2021 dhe konkretisht nga 11.6% në 12.1% në vitin 2021 .

Shpenzimet korrente ku përfshihen shpenzimet e personelit, shpenzimet operative, subvencione dhe të gjitha llojet e transferimeve janë në zbritje nga 2019 në 2021 dhe konkretisht nga 88.4% në 87.9% .

Shpenzimet për paga janë në rënje nga 2019 në 2021 dhe konkretisht nga 24.8% në vitin 2019 në 23.6 % në vitin 2021.

Norma e shpenzimeve për politikën sociale për vitet 2019-2021 varion nga 40% në vitin 2019 në 41.9% në vitin 2021. Në vitin 2018 kemi raportin e normës së shpenzimeve në politikën sociale konkretisht me 27.2% , kjo sepse në planin e pritshëm të vitit 2018 kemi të pasqyruar planin e akorduar për pagesën e ndihmës ekonomike dhe paafesise vetëm për 10 muaj . Kjo sepse ky fond akordohet nga qeveria çdo 2 muaj dhe jo vjetor.

Referuar Tabelës F14 Treguesit financiarë

4.5.4 Rreziqet financiare dhe fiskale

Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin. Ligji përmban koncepte dhe përgjegjësi të reja për menaxhimin e riskut në institucionet publike.

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme që kanë efekt të dëmshëm mbi përmbushjen e objektivave të njësisë publike dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen. Risku matet sipas efektit të tij dhe shkallës së probabilitetit të ngjarjes.

Identifikimi dhe menaxhimi i riskut mundëson strukturat drejtuese në çdo njësi në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi që kanë për realizimin e aktivitetit në to. Çdo drejtues është i vetëdijshëm se risku do të ekzistojë dhe nuk do të eliminohet kurrë tërësisht. E rëndësishme është që risku të menaxhohet në mënyrë efektive.

Strategjia e riskut përkufizohet si qasja e njësisë për menaxhimin e riskut e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë publike dhe më tej. Ajo përcakton mënyrën se si sillen njësia ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat përgjegjëse për menaxhimin, monitorimin dhe raportimin e risqeve. Për risqet që janë cilësuar më të lartat (më kritiket), duhet të hartohet një plan afat-gjatë veprimi.

Për realizimin e të ardhurave të veta vendore, njëkohësisht duke ruajtur tendencën për përmirësimin e politikave dhe strategjive incentivuese e zhvilluese të ekonomise lokale, është hartuar strategjia për menaxhimin e riskut duke kaluar në këto etapa:

- a) Identifikimi i objektivave
- b) Identifikimi i risqeve të jashtme dhe të brendshme.
- c) Analiza dhe vlerësimi i çdo risku (sipas probabilitetit dhe impaktit).
- d) Marrja e masave të metejshme, për pakësimin apo reduktimin e riskut.
- e) Paraqitja e të gjithë konkluzioneve të arritura
- f) Krijimi i hartës së riskut, grupimi në bazë të impaktit dhe probabilitetit të ndodhjes së tyre, duke treguar në këtë mënyrë ato fusha të veprimtarisë së njësisë, ndaj të cilave duhet të regohet vëmendje e veçantë.
- g) Monitorimi dhe raportimi.
- h) Hartimi i planit të veprimit për zbatimin e strategjisë.

Regjistri i Riskut

Objektivat janë planifikimi buxhetor, llogaritja, analizimi dhe kontabilizimi i burimeve financiare të të ardhurave të veta, ndjekja e politikave dhe strategjive sensibilizuese, mbështetese dhe zhvilluese për krijimin e të ardhurave, zbutjes së informalitetit, rritjes së konkurrencës së ndershme, si dhe administrimi i marëdhëniet me taksapaguesit dhe shërbimi ndaj tij.

1	2	3	4	5	6	7	8	9
N r	Përshkrimi i riskut	Risku para kontrollit	Kontrollet ekzistuese	Risqet pas kontrolleve ekzistuese	Nevoja për kontrole të mëtejshme	Veprime për të adresuar boshlleqet	Zotëruesi i riskut	Ndryshimet në risk që nga detyra e fundit (përkeqësohet => përmirësohet <= i pandryshuar =)
1.	Mungesa e informacionit në terren	mesëm-ulët	Monitorime në terren nga inspektorët e zonës	ulët-ulët	po	Përgatitja e planit të punës për evidentim	Sektori i Kontrollit dhe Vlerësimi	Përmirësuar
2	Mungesa e informacionit nga Z.R.Rr.Pasurisë Paluajtshme	mesëm - mesëm	Kërkesa shkresore për informacion	Mesëm - mesëm	Po	Rritja e bashkepunimit me Z.R.Rr.Pasurive Paluajtshme	Zyra Rajonale e Rregjistrimit të pasurive të Paluajtshme	Përmirësuar
3	Mungesa	ulët-ulët	Kërkesa shkresore për	ulët-ulët	po	Bashkepunim me	QKR dhe	Përmirësuar



	informacionit nga QKR-ja		informacion			QKR-ne	Sektori i Regjistrimit	
4	Dokumenacion i plotë arkivor	ulët-ulët	Pasurimi me dokumentacion i pronësie	ulët-ulët	Po	Pasurimi gjatë dhenies së shërbimit ndaj taksapaguesit	Sektori i Regjistrimit	Pandryshuar
1	Mungesa e informacionit në Njësitë Administrative	mesëm - ulët	Monitorime ne terren nga Njësitë Administrative	ulët - ulët	po	Grupe të zgjeruara për evdientimin e taksapaguesve	Njësitë Administrative ve dhe Sektori Familjar	Përmirësuar
2	Mungesa e informacionit nga Z.R.Rr.Pasurisë Paluajtshme	mesëm - mesëm	Kërkesa shkresore për informacion	mesëm - mesëm	Po	Rritja e bashkepunimit me Z.R.Rr.Pasurive Paluajtshme	Zyra Rajonale e Rregjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe Sektori Familjar	Përmirësuar
3	Mungesë informacioni për tokën bujqesore	mesëm - mesëm	Monitorime në terren nga Njësitë Administrative	mesëm - mesëm	po	Bashkepunim me Drejtorinë e bujqësisë	Drejtoria e Bujqësisë dhe Sektori Familjar	Pandryshuar
4	Shërbim pranë taksapaguesit	ulët - ulët	Rritja e mundësisë së arkëtimit pranë taksapaguesit nga ana e Agjentit Tatimor	ulët - ulët	jo	Mbështetje nga Nd/Ujësjetellës – Kanalizime	Agjenti Tatimor Nd/Ujësjetellës – Kanalizime dhe Sektori Familjar	Përmirësuar
5	Dokumenacion bazues për taksim	mesëm - mesëm	Pasurimi me dokumentacion i pronësie	mesëm - mesëm	Po	Pasurimi gjatë dhenies së shërbimit ndaj taksapaguesit	Zyra me një ndalesë dhe Sektori Familjar	Pandryshuar
1	Ndjekja e masave shtrënguese	mesëm - mesëm	Njoftime në terren dhe me postë	mesëm - mesëm	po	Përgatitja e planveprimit	Sektori i Kontrollit dhe Masave shtrënguese	Pandryshuar
2	Rakordim i shpejtë i pagesave	ulët - ulët		ulët-ulët	jo	Plan veprimi për rakordimin e të ardhurave	Sektori i Kontabilizimit dhe Rakordimit	Përmirësuar
3	Përmirësimi i marrëdhënies taksapagues – taksambledhës	mesëm - ulët	Sensibilizim dhe njoftime të afateve në media, propozim për taksë të përballueshme dhe incentive, ndarje e detyrimeve në këste, etj.	ulët-ulët	jo	Trajtimi dhe interpretimi i kërkesave nga subjektet	Sektori i Regjistrimit, specialisti i shërbimit ndaj taksapaguesit	Përmirësuar
1	Realizimi i të ardhurave nga bizneset	ulët-ulët	Analiza mujore sipas zërave	ulët-ulët	po	Shqyrtimi i zërave sipas ecurisë	Sektori i kontrollit dhe masave shtrënguese	Përmirësuar
2	Realizimi i të ardhurave nga familjet	mesëm - ulët	Analiza sipas Njësite Administrative	ulët-ulët	po	Shqyrtimi i sipas ecurisë	Sektori familjar	Përmirësuar
3	Realizimi i të ardhurave nga agjentë tatimorë	ulët - mesëm	Analiza mujore	ulët - mesëm	po	Analizë për çdo agjent	Sektori i Kontabilizimit dhe Rakordimit	Përmirësuar
4	Realizimi i të ardhurave nga Drejtori të tjera dhe Institucione varësie	ulët - mesëm	Analiza mujore	ulët - mesëm	po	Analiza sipas Drejtorive të tjera dhe institucioneve të varëse sipas zërave	Drejtoritë e tjera dhe Institucionet e varësisë të bashkisë, sipas të ardhurave që planifikohet të realizojnë	Përmirësuar



1	Adaptimi dhe implementimi i programit të kompjuterizuar	mesëm- ulët	Bashkëpunim me programuesit për adaptimin dhe implementimin e programit	ulët-ulët	po	Evidentimi dhe shqyrtimi i nevojave për ndryshime dhe adaptime në program	Programuesit e Sistemit dhe Sektori i regjistrimit dhe llogaritjes së detyrimit	Përmirësuar
1	Dhënia e informacionit për taksapaguesit	mesëm- ulët	Dhënie e shërbimit pranë sportleve	ulët-ulët	jo	Shqyrtimi i kohës që konsumon tatimpaguesi	Sektori i regjistrimit dhe Zyra me Një ndalesë	Përmirësuar
2	Llogaritje e shpejtë	ulët-ulët	Përfshirje e llogaritjes së detyrimit në sistemin e kompjuterizuar	ulët-ulët	po	Shqyrtimi i nevojës së tatipaguesve	Programuesit e Sistemit dhe Sektori i regjistrimit dhe llogaritjes së detyrimit	Pandryshuar
3	Evidentim i shpejtë i pagesave	mesëm- ulët	Kontabilizim i shpejtë i të ardhurave	ulët-ulët	jo	Monitorimi i kohës për emetimin e evidencave	Sektori i Kontabilizimit dhe Rakordimit	Përmirësuar
4	Shërbime dhe veprime on-line për taksapaguesin	mesëm- ulët	Bashkëpunim me programuesit	mesëm- ulët	po	Shqyrtimi i nevojës së tatipaguesve	Programuesit e Sistemit dhe Sektori i regjistrimit dhe drejtoria	Pandryshuar
1	Përditësim me standartet e reja ligjore	ulët- ulët	Shqyrtimi i njohurive dhe evidentimi i ndryshimeve	ulët- ulët	po	Krahasimi dhe diskutimi periodik mbi njohuritë	Drejtoria Ardhurave	Pandryshuar
2	Njohuri mbi sistemet e fundit informatike të instaluar	ulët- ulët	Shqyrtimi dhe krahasimi nevojat e me programeve	ulët- ulët	po	Kontrolle periodike mbi nevojën për njohuritë	Drejtoria Ardhurave	Pandryshuar
3	Njohje me eksperiencë të ngjashme dhe trainime profesionale	mesëm- ulët	Trainime dhe diskutime mbi to	ulët- ulët	po	Diskutime dhe konstatime	Drejtoria Ardhurave	Përmirësuar